

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

Konkurs

Këshilltar afatgjatë për Zyrën e Prokurorisë publike Projekt i mbështetur nga BE “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit”

Punëdhënësi:	Agjencia për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik (AEI)
Lokacioni:	Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Lloji:	Këshilltar lokal afatgjatë
Fillimi i pritshëm:	Prill 2022
Kohëzgjatja e pritshme:	Prill 2022 – deri në fund të projektit (Janar 2026)

HISTORIA

Këshilltari afatgjatë do të punojë në fushën e prokurorisë si pjesë e ekipit zbatues për projektin e financuar nga granti i Bashkimit Evropian “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Instituti Ludwig Boltzmann i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut.

Objekti i përgjithshëm i projektit është forcimi i sundimit të ligjit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Komponenti 1 zbaton objektivin specifik të mëposhtëm: Të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për të dhënë drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.

Një nga rezultatet e pritura në Komponentin 1 të projektit “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” është 1.1 Mbështetja këshillimore strategjike e ofruar për aktorët në sistemin gjyqësor.

Këshilltari afatgjatë do të ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë të përditshme për zyrën e Prokurorisë publike.

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Fusha kryesore e punës së tij/saj do të jetë fuqizimi i kapaciteteve institucionale të ZPP lidhur me planin e punës, që mbulon Aktivitetin 1.1.1. Vlerësimi i përgjithshëm dhe Aktiviteti 1.2.2 Mbështetja e fuqizimit të kapaciteteve të Kryeprokurorit të Republikës së Maqedonisë së

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

Veriut për organizim/menaxhim më të mirë të brendshëm dhe përmirësim të komunikimit dhe mbështetjes për PP në vend.

Nën drejtimin dhe mbështetjen e Liderit të Komponentit 1 dhe ekspertëve, këshilltari do të mbulojë aspektet për ZPP lidhur me aktivitetet e mëposhtme në Komponentin 1 - Aktiviteti 1.1.2 Mbështetja e zbatimit të Strategjisë për reformën e sektorit gjyqësor dhe procesin e reformës, aktiviteti 1.1.3 Mbështetja e menaxhimit të burimeve njerëzore (MBNJ) të gjyqësorit dhe prokurorisë publike, aktiviteti 1.2.1 Analiza dhe përmirësimi i zinxhirit të drejtësisë dhe procesit të zbatimit me qëllim rritjen e efikasitetit, Aktiviteti 1.2.3 Promovimi i idesë së specializimit në ZPP dhe KI për përshpejtimin e hetimeve dhe përdorimin e njohurive të specializuara në mënyrë të qëndrueshme, Aktiviteti 1.2.5 Mbështetja e ngritjes së kapaciteteve të Këshillit të Prokurorëve publikë dhe Këshillit gjyqësor, Aktiviteti 1.3.1 Mbështetje për zbatimin e Strategjisë së TIK-ut, Aktiviteti 1.4.1. Mbështetja e funksionimit të Akademisë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, Aktiviteti 1.5.1. Mbështetja e mekanizmit koordinues në sektorin e drejtësisë maqedonase.

Këshilltari do të bashkëpunojë me të gjitha PP dhe do të ofrojë mbështetje përmes trajnimit dhe mentorimit duke ofruar mbështetje të përditshme për prokurorët, hetuesit, asistentët ligjorë dhe stafin mbështetës sipas kërkesës.

Sa i përket aktiviteteve të parashikuara në Planin e punës për Komponentin 1, prioriteti i parë është mbështetja e procesit të një vlerësimi të përgjithshëm të standardeve të punës në ZPP dhe përgatitja e një metodologjie për vlerësimin dhe monitorimin e reformave në lidhje me nivelin e përgatitjes së Strategjisë së re për reformën e sektorit gjyqësor për periudhën 2023 – 2027.

Detyrat e këshilltarit do të përfshijnë gjithashtu ofrimin e mbështetjes për forcimin e kapaciteteve të Zyrës së Kryeprokurorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për një organizim/menaxhim më të mirë të brendshëm dhe për të përmirësuar komunikimin dhe mbështetjen për PP në vend.

REZULTATET E PRITURA

Nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e liderit të komponentit dhe ekspertëve të tjerë afatmesëm dhe afatshkurtër:

- Ofrimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë të përditshme për Zyrën e Prokurorisë publike (ZPP)
- Trajnim dhe mentorim duke ofruar mbështetje të përditshme për prokurorët, hetuesit, asistentët ligjorë dhe stafin mbështetës
- Hartimi i raporteve/analizave në lidhje me ZPP
- Zhvillimi i rekomandimeve dhe ofrimi i këshillave për Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut për organizim dhe menaxhim më të mirë të brendshëm

EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

- Rishikimi i modelit ekzistues dhe përmirësimi i komunikimit në ZPP dhe ndërmjet ZPP dhe institucioneve gjyqësore për të përmirësuar efikasitetin në lidhje me bashkëpunimin e brendshëm dhe ndërkombëtar.
- Përgatitja e materialeve për ekspertët dhe koordinimi i misionëve të ekspertëve, lidhur me ZPP
- Rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues në lidhje me ZPP dhe ofrimi i këshillave/mbështetjes për ZPP për përshtatjen/hartimin e rregullave dhe rregulloreve të brendshme
- Zhvillimi i materialeve dhe këshillave në lidhje me monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të Strategjive (Reformat/MBNJ/TIK)

KËRKESAT

- Diplomë akademike në drejtësi
- Provim i jurisprudencës
- Së paku 8 vjet përvojë në institucione të drejtësisë
- Ka demonstruar nivel të lartë profesionalizmi dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në një mjedis kompleks dhe me një afat kohor të ngushtë
- Rrjedhshmëri e gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur
- Aftësi të shkëlqyera ndërpersonale dhe komunikuese duke përfshirë përvojën në kryerjen e vlerësimeve të mangësive, vlerësimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve

PËRPARËSITË:

- Diplomë pasuniversitare në të drejtën penale do të ishte një avantazh i veçantë
- Përvojë pune në Prokurorinë Publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- Përvojë e gjerë në ngritjen e kapaciteteve në institucionet gjyqësore
- Përvoja e mëparshme e punës në projektet e BE-së

SUBMISSION OF APPLICATIONS

Aplikacionet duhet të dërgohen në mojca.kuzmicki@rol.mk dhe benedikt.welfens@rol.mk deri më 15.04.2022, duke shënuar "Long-term Adviser for the support for Public Prosecution Office" në titullin e e-mailit (subject), dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për intervistë.

Eksperti i përzgjedhur do të nënshkruajë një kontratë për servis me projektin. Do të jetë përgjegjësia e tij/saj e vetme që të respektojë të gjitha kërkesat ligjore për vetëpunësim si dhe të mbulojë të gjitha taksat dhe tarifat e parashikuara.

Eksperti nuk duhet të ketë pasur kontratë pune me administratën publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut së paku 6 muaj para punësimit.